

Atletika, arsye për të qenë krenarë!

Njeriu, i cili është përballë meje sot nuk ka fizikun e një atleti dhe nëse dikush nuk di asgjë nga historia e Atletikës Shqiptare, mund ta ngatërrojë me një pasionant pikturë apo një njeri i cili shijon verën dhe ushqimin cilësor. Përshtypjet e para janë gjithnjë të gabuara.

Njeriu që është përballë është një mbret i vërtetë në mbretëreshën e sportit shqiptar, Atletikën. Ai është Gjergj Ruli, Presidenti i Federatës Shqiptare të Atletikës, një njeri i kthjellët si kristal, që i ka idetë e qarta dhe logjikën e përvojën e shëndoshë. Ka mbaruar Institutin e Sporteve “Vojo Kushi” në Shqipëri 1984, e më pas në vitin 1996 është laureuar në Universitetin e Urbinos, Itali ku ka kryer dhe masterin. Eshte 30 vjet kampion rekordmen në kërcim së gjati e 100 m një ikonë e gjallë e sportit shqiptar.

Kudo në jetë diferencën e bën pasioni. Njeriu që është përballë i ka kushtuar jetën e tij Atletikës, një sporti superpopullor, por në Shqipërinë tonë vëmendja që i jepet këtij sporti është e cunguar.

Z. Ruli si qëndron atletika përballë sporteve të tjera?

Kur flitet për sportin sot, përgjithësisht i referohen futbollit. Duhet të ndajmë futbollin nga pjesa tjetër e sporteve. Futbolli është një industri e jashtëzakonshme. Por Atletika është “Mbretëresha e sporteve”. Jemi një sport i shkëlqyer. Një botë e tërë mban frymën pezull 10 sekonda në garën e 110 metërshit. Kjo po ndodh këto ditë në Moskë e në mbarë globin.

Dikur keni qenë një kampion i madh, bile nje rekordmen i nivelit botëror deri në moshën 17-vjeçare, ku talenti shpërfilli çdo pengesë të asaj kohe, ndërsa sot jeni në krye të FSHA. Ç' ndodh me atletikën shqiptare?

Nuk jam vetëm unë përfaqëues i talentit, por një brez i tërë atletësh kampionë shokët e mi të sakrificave e të stërvitjes, Klodeta Gjini, Ajet Toska, Marinda Preka, Eduart Salillari, Nikolin Dionisi, Oltion Luli, Pavlina Evro, Koço Mulla, Arben Mlloja, Artan Duka, Kastriot Sulçe, Alma Qeramixhi, Alma Thano Klodiana Shala etj., etj.

Pra nuk jemi një federatë, e cila nuk prodhon kampionë të mëdhenj. Jemi një vend dhe një shtet që fatkeqësisht e ka shumë të vështirë që të gjenerojë fitues të mëdhenj olimpikë sepse kushtet janë në disfavorin tonë. Kemi ndërtuar dy pista sintetike një në Tiranë, e ndërtuar me buxhetin e Federatës Botërore të Atletikës dhe një në Korçë, e ndërtuar me buxhetin e Federatës Shqiptare të Atletikës. Nga regjimi i mëparshëm kemi trashëguar palestrat e amortizuara plotësisht ku atletët stërviten në kushtet më minimale të stërvitjes profesionale. Mungon totalisht edukimi atletik në shkollat tetëvjeçare atje ku është fidanishtja e sportit, ku mund të ekzistojnë talente të fuqishme por që nuk arrijnë të kultivohen si duhet për shkak të mungesave të politikave zyrtare që duhet t'i mbështesin e zhvillojnë këto talente dhe sportistët në përgjithësi. E kemi bërë kaq herë prezent në media e kudo shqetësimin tonë për këtë mbështetje të cunguar e të munguar si dhe në një takim të posaçëm me elitën e sportit në Hotel Tirana me temë “Të shpëtojmë sportin” ku pjesëmarrës ishin sportistë e trajnerë të thinur që e duan me shpirt sportin dhe mungonin ata që duan karrigen në sferat e sportit. Atletika është i vetmi sport që suvencionohet financiarisht nga shteti ndaj dhe fuqia dhe zhvillimi i këtij sporti varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga mbështetja financiare që i jep

shteti. Fatkeqësisht situata në Atletikë është e tillë, shumë komplekse, shumë e debatueshme dhe e diskutueshme. Nuk do të mjaftonte as një kongres i jashtëzakonshëm brenda sportit vendor për ta zgjidhur.

A ka pasur zhvillime cilësore atletika këto vite të mandatit tuaj si president i FSHA-së?

Me keqardhje e them se është shumë i mangët gjykimi i jashtëm i disa individëve gjithnjë të pakënaqur me arritjet dhe zhvillimet e atletikës, por e vërteta është se atletika sot është më mirë se ç'ka qenë e më mirë do të bëhet dhe duke pasur parasysh kushtet në të cilat ajo zhvillohet, mbështetjen e paktë financiare e politikat jo në favor të saj, mund të themi me krenari se kemi zhvillime cilësore, medalje të fituara në kompeticione kombëtare e ndërkombëtare që nuk janë pak për një vend të vogël si Shqipëria, ku përveç kalendarit të përvitshëm kombëtar të aktiviteteve të zhvilluar rregullisht e me cilësi, kemi zhvilluar evente të rëndësishme të niveleve botërore, për herë të parë në Shqipëri Kampionatin e 27-të Botëror të Vrapimit në Mal, dy mitingje ndërkombëtare kupa “Pietro Mennea”, kupa “Robert Emian” me praninë e profesioniste të ndërkombëtarëve të cilët i kanë vlerësuar maksimalisht. Atletika Shqiptare mbyll sezonin e aktiviteteve në madhësinë e Kampionatit Botëror të Moskës, ku performacat e atletëve tanë ishin të shkëlqyera në lidhje me rezultatet e tyre personale. Mes sakrificave të mëdha ne kemi arsye për të qenë krenarë!

Sot në botë është rritur kredibiliteti i vendit tonë para organizmave më të fuqishëm të Atletikës në botë, Federatës Botërore e asaj Europiane të Atletikës. Me krenari e them se përveç jehonës së jashtëzakonshme në mediat botërore e në faqet zyrtare të organizmave botërorë të atletikës, si IAAF, WMRA, etj., emri i Federatës Shqiptare të Atletikës është

gdhendur në Muzeun e Katalonjës në Barcelonë për organizimin e shkëlqyer të Kampionatit të 27-të Botëror të Vrapimit në Mal në Tiranë në 2011.

Kjo krenari është legjitime pasi para pak ditësh në Kampionatin Ballkanik të mbajtur në Stara Zagora, Bullgari, Shqipërisë më 2014 iu besua zhvillimi i Maratonës Ballkanike. Ky është një nder i madh për FSHA-në por dhe një vlerësim për punën e stafit të saj, kryesisë e gjithë komunitetit të atletikës.

Sa është sot për sot buxheti vjetor i Federatës Shqiptare të Atletikës?

Ka një rënie drastike nga viti në vit. Sot mund të themi që kemi një buxhet prej 45 milionë lekësh të vjetra në dispozicion.

Duket një shifër qesharake, është për të ardhur keq. Si mbijeton atletika?

Ne kemi aktivitete vendore dhe aktivitete ndërkombëtare. Në aktivitete ndërkombëtare kemi si synim që të jemi prezentë në shumicën e ngjarjeve të mëdha. Nuk duhet të mungojmë në Ballkaniada, Europeanë apo Botërorë. Do të ishte fatkeqësi për sportin shqiptar. Por, megjithatë ne kemi sjellë 6 medalje këtë vit, 6 medalje në arenën ndërkombëtare. Nuk janë pak apo jo?!

Ku bazohet pjesëmarrja në këto aktivitete? A është e detyruar? Si funksionon fryma e grupit në kryesinë e FSHA-së?

Kur dikush zgjedh një pasion, çdo gjë diktohet prej tij. Mua personalisht më udhëheq pasioni për këtë sport. Kjo është shtysa jonë më e fuqishme

jo vetëm e imja por e të gjithëve si kryesi e federatës dhe në përgjithësi e gjithë komunitetit të atletëve të të sinqertë, të cilëve u dhemb për atletikën dhe jetën e saj. Në kryesi janë 6 kampionë të atletikës, Oltion Luli kampion rekordmen i 100 m e 200 m, Arben Milloja kampioni legjendar i 10 garëshit , Zhuje Bajko kampione e hedhës së shtizës, Hamit Demiri kampion në 1500 m, Koço Mulla ish rekordmen në kërcim së gjati dhe 100 m, Ferdinand Canaj pedagog pranë Universitetit të Sporteve dhe Nikolin Dionisi kampion rekordmen në 800m dhe 1500m. Ky është një staf super i motivuar profesionistësh kampionë rekordenë që i merr vendimet në kolegjalitet, ku janë të mirëpritura opinionet dhe sugjerimet dhe nga jashtë kryesisë, ku bashkohet talenti dhe fryma e profesionistëve me aftësitë e administrimit të përgjegjësive. Kjo është dhe përgjigja më e mirë për këdo që sulmon profesionizmin, talentin, sakrificat dhe pasionin e një brezi të tërë, që emrin e karrierën e tyre e kanë ngritur më gjak dhe me medalje, me atribute të pashembullta.

Çfarë buxheti do të duhej për të realizuar aktivitetet vendore dhe ndërkombëtare?

Federata i kërkoi MTKRS-së që të përmbushë detyrimet për programin e FSHA për vitin 2013, shumën 130 milion lekë të vjetra sipas kalendarit të aprovuar nga Asambleja si dhe nga Federata Europiane dhe ajo Botërore.

Në ç' pozicion është atletika shqiptare me sportet e tjera në vend?

Futbolli ka prioritetin e sipërmarrjes, të biznesit dhe teknologjisë. Ndërsa ne jemi modestë, por shumë dinjtozë. Po ju kujtoj kemi sjellë këtë vit 6 medalje nga arena ndërkombëtare. Atletika bazohet mbi rezultatet individuale dhe talentet janë më të dukshme sesa në futboll, psh ku

rezultatet bazohen në punën në grup. Nuk dua të fyej askënd, sepse të gjithë ata që merren me sport janë një shembull i shkëlqyer, por mendoj se krahasimi në një formë globale nuk ekziston. Atletika është e vecantë. Është e paevitueshme që sot në sportin modern të mos flitet për atletikën. Është atletika që i bën sportet e tjera si futbollli, basketbolli, etj., të bëjnë diferencën nga skuadra në skuadër. Atletika është suport i fuqishëm dhe për sportet e tjera. Një futbollist i mirë në fushë, duhet të jetë fillimisht një atlet i mirë.

Sa është buxheti i atletikës në rajon?

Greçia që po kalon një krizë të madhe ekonomike, po përballet me një buxhet tre herë më të vogël se i viteve paraardhëse në shumën 5 milionë euro, gjithashtu dhe Bullgaria me 1.3 milionë euro. Mali i Zi dhe Maqedonia e kanë dhjetë herë më shumë se ne. Bëjini vetë llogaritë.

Si mundet që të realizohen të gjitha këto aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare me këtë buxhet qesharak?

Është e kuptueshme vështirësia qëndron, duke harxhuar shumë energji për të siguruar dhe eksploruar të ardhura; ne sot bëjmë me kalendar mbi 15 aktivitete kombëtare, me një gjyqtari që është shumë e madhe në numër për të gjykuar disiplinë për disiplinë. Duke shtuar edhe aktivitetet ndërkombëtare si ballkaniada, europianët, botërorët dhe mitingjet ndërkombëtare, duke përfshirë dhe një miting ndërkombëtar në Tiranë kanë të paktën 4-5 herë më shumë shpenzime.

Si i siguron të ardhurat?

Buxheti i shtetit na jep disa thërrime dhe pjesën tjetër me ndihma dhe grante te ndryshme nga Komiteti Olimpik, Federata Botërore dhe Europiane të cilët theksoj na kanë mbështetur financiarisht më tepër se strukturat tona kombëtare, si dhe nga biznesi privat dhe qoftë dhe nga buxheti personal. Përdor lidhjet e mia dhe miqtë e mi, apo biznese që janë dashamirëse. I jam përkushtuar atletikës dhe gjithçka e vë në funksion të saj. Shfrytëzoj gjithçka mundem që t'i krijoj kushte këtij sporti.

A kemi ne atletë të rëndësishëm në Shqipëri? A ka më kampionë sot? Si është atletika shqiptare me rezultate në krahasim me këto shtetet ballkanike?

Po, kemi disa realisht shumë të rëndësishëm. Luiza Gega në rang rezultatesh është më e mira që kemi pasur, krenaria e shumë viteve të fundit. Vrapimet janë gjithnjë të vështira dhe të konkurrosh në kategoritë kur merr pjesë ajo është një gjë unike për sportin e një vendi modest si Shqipëria. Por boshti i Atletikës nuk është vetëm një njeri i talentuar si Luiza. Çdo disiplinë e atletikës ka heroin e vet; Luiza është mbretëresha e garës 1500m, Adriatik Hoxha është mbreti i hedhjes së gjyles, në kërcim së gjati po përgatitet të bëhet mbret Izmir Smalaj etj.

Në raport me fqinjët ballkanikë ,jemi dinjitozë, jemi në altar në disa garime duke llogaritur që atletika është një oqean me disiplina. Padyshim Luiza Gega është në këtë altar, ajo vetëm këtë vit ka marrë në arenën ndërkombëtare 5 medalje, që nga ajo e Arit si Kampione ballkanike si dhe të tjera në Lojërat Mesdhetare në turqi, nga mitingje ndërkombëtare, por në Moskë, në Kampionatin Botëror që po zhvillohet aktualisht ajo shpalosi një performancë të mrekullueshme.

Vetëm Gega dhe kaq? A kemi ne një brez të ri atletësh?

Jo ne kemi pasur këtë 10 vjeçar, shumë atletë të talentuar që kanë qenë protagonistë si në arenën kombëtare, por edhe atë ndërkombëtare. Klodiana Shala rekordmene dhe kampione në 100 m, 200m, 400m, Dorian Çollaku rekordmen dhe kampion në hedhjen e çekiçit, Elton Bitincka kampion dhe rekordmen në 110 metra me pengesa, Armir Bregu rekordmen në kërcim së gjati. Por këto emra po i lënë stafetën një brezi tjetër, ashu siç edhe ne ua lamë këtyre. Metamorfoza e kohës sjell ndryshime në cilësi, por nuk ka sjellë këto vite dhe kushte shumë të favorshme. Brezi i atletëve të rinj që po ngjisin shkallët e altarit dhe do të bëhen shumë shpejt konkurrentë dinjitozë në arenën ndërkombëtare ashtu si Luiza Gega, përfaqësohet nga emra si: atleti super i talentuar Izmir Ismalaj i garës së kërcimit së gjati që konkuroi këto ditë me shumë dinjitet në Kampionatin Botëror në Moskë 2013 duke marrë rezultatin më të mirë personal; Adriatik Hoxha hedhësi i gjyles që ka përmirësuar rekordin e kësaj gare në 3 metra; Kledis Hallunaj në kërcim së gjati; Bajram Muça në 110 metra me pengesa; Eneda Deliu në 100 m dhe 200 m; Suat Boshku në kërcim trihapësh; atleti kosovar Astrit Kryeziu që mori edhe nënshtetsinë shqiptare.

A ka rrezik për këtë brez talentesh në kushtet e Shqipërisë?

Rreziku është i pranishëm. Ne po mundohemi me gjithë format që ti japim dhe t'i ushqejmë këtij brezi dëshirën e madhe dhe perspektiven që i pret. Ne po negociojmë bashkë me sekretarin Nikolin Dionisi çdo ditë me drejtuesit e këtyre atletëve, por edhe ata ndërkombëtarë për të parë mundësinë që të sigurojmë bursa stërvitore ndërkombëtare si atletë me

perspektivë. Gjithashtu ky bashkëpunim është në lidhje të vazhdueshme edhe me Komitetin Olimpik Shqiptar.

A janë të mundura këto bursa stërvitore? Duhet të kushtojë shumë ky proces?

Është shumë më pak sesa e mendoni ju. Është vetëm 45 dollarë në ditë dhe përfshin fjetje, stërvitje, ushqim, si dhe trajtim mjekësor dhe një atlet mund të stërvitet në kampin sportiv më prestigjioz të Kubës, Italisë, Ukrainës, Hungarisë, etj., sipas specializimit që jep ky kamp, gjithmonë i mundësuar nga IAAF.

Pra me 10-12 mijë dollarë në vit ne mund të fitojmë një kampion të specializuar dhe të garantuar? Po si mund të çojmë ne dikë me fondet që kemi në dispozicion?

Sportin e bën shteti dhe këtë duhet ta kuptojnë të gjithë. Këtu nuk flitet për futbollin, flitet për sportet e tjera. Ne kemi vetëm një mision, të mos ndalojmë gardën e vjetër së trajnerëve së shpresuari për të punuar. Nëse ata do të dorëzohen, atëherë ju siguroj se shumë sporte do shuhen. I bëj thirrje strukturave qeveritare të mbështesin sportistët në programet e tyre të trajnimit përmes këtyre bursave stërvitore prej të cilave shqiptaria ka veç mirë dhe për të nxitur e ngjallur shpresën e talenteve të reja se rezultatet dhe pasioni e talenti i tyre nuk do të shkojnë kot, por do të mbështeten për t'u zhvilluar më tej në mënyrë që ta shohim sa më shumë flamurin e Shqipërisë në ngjarje të tilla si kampionatet botërore e të ndihemi krenarë me atletët tanë.